

Përmbledhje



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

SUBJEKT I MONITORUAR: ETELEVA GJAMO, GJYQTARE, GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË KORÇË

RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE DATË 04/11/2022 PRANË KPK:

Proçesi i rivlerësimit për subjektin ishte realizuar vetëm mbi bazën e kriterit të pasurisë sipas nenit 33 të ligjit 84/2016

Kritet i pasurisë: Sipas KPK, raporti i ILDKPKI informon se nuk ka burime të ligjshme, nuk ka kryer deklaram të saktë nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk është në situatën e konfliktit të interesave familjare.

Mbi kriterin e Kontrollit të Figurës: Raporti i DSIK ishte pozitiv ku konfirmohej përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

Mbi kriterin e aftësive profesionale: Raporti i KLGJ ishte pozitiv ku janë marrë në shqyrtim 5 dosje të shortuara dhe 3 dokumente ligjor nga subjekti. Nuk u evidentuan problematika. Pranë KPK janë depozituar 6 denoncime nga ana e publikut, ku parashtrimet lidhen me themelin e çështjes, janë kërkuar shpjegime nga ana e subjektit për vetëm 2 prej tyre, të cilat nuk u relatuan në seancë.

Vëzhguesi vërejti gjatë seancës dëgjimore, se parimet mbi solemnitetin dhe etikën nuk u respektuan plotësisht, nga kryesuesja Znj. Zhegu apo dhe nga anëtarja Znj. Shuli, pasi u konstatua komunikim mes dy anëtarëve, përdorimi i celularit, letërkëmbim me shënime në letra mes tyre.

**Në seancën për shpalljen e vendimit datë 08.11.2022
Eteleva Gjama konfirmohet në detyrë.**



Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Znj. Etleva Gjamo, përballat me rivlerësimin e saj në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

Me datë 04.11.2022 ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Znj. Etleva Gjamo, Gjyqtare pranë Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Korçë për shkak të funksionit si gjyqtar, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

Trupa gjykuese përbehet nga Suela Zhegu Kryesuese, Brunilda Bektashi Relatore dhe Firdes Shuli Anëtare, si dhe asistuar nga vëzhguesi ndërkombëtar Tonci Petkovic në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

KPK informon se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tri kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Gjithashtu KPK relatton se subjekti i rivlerësimit është njoftuar për: (i) rezultatet e hetimit kryesisht (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr.84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 – 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti nuk ushtroi të drejtën e përfaqësimit me avokat, nuk paraqiti kërkesa paraprake apo procedurale në lidhje me hetimin ose trupën gjykuese.

Relatori i çështjes mori një kohë të gjatë rreth 1 orë e 10 min, për të relatuar dosjen hetimore mbi kriterin e pasurisë, në mënyrë jo proporcionale me dy kriteret e tjerë. Referuar edhe eksperiencës së subjektit mbi 22 vite punë si gjyqtare, relacioni u bazua kryesisht në kriterin e pasurisë dhe problematikave me disa pasuri të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit.

Mbi kriterin e pasurisë: Sipas KPK, raporti i ILDKPKI informon se nuk ka burime të ligjshme, nuk ka kryer deklaram të saktë nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk është në situatën e konfliktit të interesave familjare.

Mbi kriterin e Kontrollit të Figurës: Raporti i DSIK ishte pozitiv ku konfirmohej përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

Mbi kriterin e aftësive profesionale: Raporti i KLGJ ishte pozitiv ku janë marrë në shqyrtim 5 dosje të shortuara dhe 3 dokumente ligjor nga subjekti. Nuk u evidentuan problematika. Pranë KPK janë depozituar 6 denoncime nga ana e publikut, ku parashtrimet lidhen me themelin e çështjes, janë kërkuar shpjegime nga ana e subjektit për vetëm 2 prej tyre, të cilat nuk u relatuan në seancë.

Vëzhguesi vërejtë gjatë seancës dëgjimore, se parimet mbi solemnitetin dhe etikën nuk u respektuan plotësisht, nga kryesuesja Znj. Zhegu apo dhe nga anëtarja Znj. Shuli, pasi u konstatua komunikim mes dy anëtarëve, përdorimi i celularit, letërkëmbim me shënime në letra mes tyre.

Në seancën për shpalljen e vendimit datë 08.11.2022 subjekti i rivlerësimit u konfirmua në detyrë.